



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 01.06.2020,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

**Munguan:** Jeta Rafuna dhe Blerand Stavileci.

**Të pranishëm ishin edhe:** Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, dhe Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Osman Bllaca dha sqarime lidhur me pikën e dytë, duke cekur se te pakoja ekonomike është vendimi i njëjtë, vetëm shtohen disa mjete tjera.

**Agim Gashi** kërkoi që për Kuvend të jetë me shkrim ndonjë propozim i shkurtër, sa për orientim, lidhur me pakon ekonomike.

**Osman Bllaca** informoi se për seancë të Kuvendit do të jetë edhe një pikë shtesë: "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa".

**Agim Gashi** kërkoi që për Kuvend të jetë një pikë shtesë: "Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi gjendjen e arsimit gjatë periudhës së pandemisë Covid -19".

**Shpresa Shala** tha se në Kuvend do të raportojmë për punët që janë zhvilluar gjatë kohës së pandemisë në arsim.

**Agim Gashi** kërkoi që mundësisht të jetë një informatë lidhur me përqindjen e fëmijëve që nuk kanë arritur ta përcjellin mësimin në distancë.

**Shpresa Shala** tha se në mbledhjen e radhës së Kuvendit t do të raportojmë për këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

### REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes urgjente të Komitetit për Politike financa;
2. Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjetet shtesë me rastin e Covid -19;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar - mars 2020 (TM 1) ;
4. Informatë mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019 -2020;
5. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtina për vitin 2019 ;
6. Diskutimi për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2019;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut;
8. Të ndryshme.

**Pika e parë.**

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes urgjente të Komitetit për Politike Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes urgjente të Komitetit për Politike Financa.

**Pika e dytë**

Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjetet shtesë me rastin e Covid -19.

Kryesuesi tha se sa i përket Propozimvendimit për aprovimin e pakos ekonomike për mjetet shtesë me rastin e Covid -19, këtë material do ta shqyrtojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjetet shtesë me rastin e Covid -19 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tretë**

Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar - mars 2020 (TM 1).

Sa i përket Shqyrtimit të raportit financiar për periudhën janar - mars 2020 (TM 1), sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, duke cekur se ky raport është bërë shumë më herët, diku rreth datës 20 prill, dhe nuk është përfshirë pakoja

dhe bartja, mirëpo në muajin e ardhshëm bëhet TM 2 dhe përfshihet komplet edhe pakoja, edhe bartja e mjeteve.

**Agim Gashi** tha se në këtë raport është prezantuar vetëm planifikimi, në vlerë prej 91,579,504 €, dhe është thënë të planifikuara janë 29 milionë e të hyrave vetanake dhe nuk janë specifikuar të hyrat nga niveli qendror sipas destinimit. Në raport duhet të ceket specifikimi, sepse ai është i domosdoshëm.

Është një detal tjetër, të cilin nuk e kemi analizuar as vitin e kaluar, që ka sasi mjetesh që vinë si rezultat i Ligjit për Prishtinën dhe që nuk mund t'i shpenzojmë, pra janë pagat për policinë dhe për shëndetësinë. Në mungesë të harmonizimeve ligjore, këto mbeten të pashpenzuara dhe si të tilla barten poshtë e larte brenda një shtetit, kështu që Drejtoria e Financave duhet t'i japë instruksionet dhe të ketë takime këmbëngulëse për këto probleme.

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke cekur se është një komision që formohet në bazë të Ligjit për financat e pushtetit lokal, që formohet nga Kryeministri dhe ministri i Financave, ku ata e kanë për obligim të merren me këtë çështje.

**Agim Gashi** theksoi se janë disa gjëra në raport që nuk përputhen, ku në një vend është thënë për shpenzimet kapitale janë 3.70 %, në vendin tjetër 0.95%, andaj kërkoj të dijë se cila është e saktë. Njëherësh kërkoi sqarim edhe për përqindjen prej 3.27 %.

**Valbona Makolli** tha se shpenzimet kapitale janë shpenzuar 0.93% në krahasim me vitin e kaluar për të njëjtën periudhë që kemi raportuar, ku ka rënie 0.20% më pak se vitin e kaluar. Përqindja prej 3,27% mendoj se është gabim teknik dhe këtë do ta përmirësojmë.

**Agim Gashi** tha se, sido që të jetë, janë afro 800 mijë euro ma pak, vetëm Drejtoria e Parqeve ka shpenzuar pak mjete dhe dy drejtori të tjera që kanë shpenzuar nga 50 mijë euro. Por një gjë nuk është precizuar, se këto mjete a janë shpenzuar prej mjeteve të bartja apo mjetet e planifikuara, dhe se kur nxirret përqindja nxirret nga tërësia buxhetore e jo vetëm nga planifikimi i të hyrave.

Lidhur me çështjet e ngritur sqarime dha **Valbona Makolli**.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar - mars 2020 (TM 1) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Informatë mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019 -2020.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019 -2020 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë, për vitin 2019.**

**Osman Bllaca** tha se për këtë ndërmarrje publike lokale në mbledhjen e radhës së Kuvendit do të raportojë Muhedin Nushi, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi shprehu mendimin se në këtë raport, përkundër situatës së krijuar, Ndërmarrja ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshme, ngase një pjesë e borxheve të akumuluar ndër vite ende mbetet e pa arkëtuar dhe menaxhmenti aktual ende nuk po mund ta kuptojë arsyen e vërtetë për këtë.

**Sami Boroci** theksoi se nuk e di a ka bazë ligjore që të jetë prezent në Kuvend kurë raportohet për këtë pikë edhe kryetari i bordit ose kryeshefi i ndërmarrjes, që nëse ne kemi pyetje ose komente çfarëdo qofshin ato, t'i parashtrijmë para tyre.

**Fadil Gashi** tha se aksionari duhet të raportojë e jo kryeshefi i ndërmarrjes.

**Halim Halimi** u shpreh i pajtimit me mendimin e z. Boroci, duke thënë se është praktikë e mirë me ardhur edhe dikush tjetër për të raportuar në Kuvend.

**Genc Sherifi** shprehu mendimin se është mirë me e ftuar edhe kryeshefin ekzekutiv ose kryetarin e bordit.

**Sami Boroci** tha se ideja është që këto raporte mos me kaluar vetëm blanko, por me i diskutuar dhe me shikuar se çka mundemi me përmirësuar dhe ndihmuar.

**Egzon Azemi** theksoi se ligjërisht kur është kjo çështje me raportuar asamblistët aksionarë, aksionarët e kanë për obligim me e ftuar kryeshefin me u raportuar edhe atyre, e nëse raportimi i asamblistëve aksionarë nuk është në nivel, atëherë duhet automatikisht me i shkarkuar për shkak se nuk e kanë kryer punën e siç duhet.

Njëherësh ai u shpreh se, më vjen mirë që një ndërmarrje më në fund po raporton, sepse kanë kaluar dy-tri vjet dhe nuk kemi asnjë raport të asnjë ndërmarrjeje publike për këto vite, kur dihet se për çdo vit është i obliguar raporti nga këto ndërmarrje. Këtë çështje e kemi diskutuar disa herë por asgjë nuk është ndërmarrë, andaj është dashur të lejohet të përfundohet mandati kështu, apo është dashur të ndërmerret masa e shkarkimit të tyre nëse asnjëri prej tyre nuk raporton?

**Sami Boroci** kërkoi që të raportojnë aksionarët e ndërmarrjes, e nëse ka detale teknike që neve mund të na interesojnë, kishte qenë mirë me qenë aty edhe kryetari i bordit ose kryeshefi.

**Fadil Gashi** tha se Kuvendi e ka zgjedhur aksionarin, aksionari e ka për obligim me raportuar në Kuvend për ndërmarrjen, por nëse aksionari nuk është për këtë, atëherë pse e keni zgjedh aksionarin!

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë, për vitin 2019 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e gjashtë**

**Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2019.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Diskutimi për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:50.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

